

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN, DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM, PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT RAJONAL PËR SHQIPËRINË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.66/2017”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr.66/2017”, vjen si nevojë e bërjes së disa ndryshimeve në tekstin e marrëveshjes së bashkëpunimit teknik për zbatimin e projektit.

Në kudër të bashkëpunimit dypalësh, ndërmjet qeverisë së Zvicrës dhe qeverisë shqiptare, është në zbatim faza e tretë, 2017-2018, e programit për zhvillimin rajonal, në vijim dhe sipas marrëveshjes kuadër, lidhur me bashkëpunimin teknik e financiar dhe ndihmën humanitare, ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe qeverisë shqiptare, nënshkruar më 11.5.2007, i cili synon të kontribuojë në zhvillimin rajonal dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

Programi për Zhvillimin Rajonal 3 (PZHR3), që nisi më 1.4.2017, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, të miratuar me vendimin nr.263, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, ratifikuar me ligjin nr.66/2017, është duke u zbatuar në kuadër të reformës së zhvillimit rajonal, të ndërmarrë nga qeveria shqiptare që prej vitit 2014. Ky projekt vjen si asistencë e partnerëve ndërkombëtarë, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në vazhdimësi të fazës paraardhëse PZHR2, të zbatuar nga qeveria shqiptare dhe të ndjekura nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, që mbulon edhe çështjet e reformës së zhvillimit rajonal, filluar nga qeveria, nën kujdesin e Kryeministrit, në vitin 2014.

Partnerët ndërkombëtarë, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), me anë të komunikimit zyrtar, kanë kërkuar, në fillim të muajit korrik 2018, si më poshtë vijon:

1. Përcaktimin e autoritetit bashkëpunues të programit. Duke qenë se, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit, ishte Ministria e Zhvillimit Urban agjencia bashkëpunëtoare e projektit (pika 1 e nenit II) dhe partneri zbatues ECORYS dhe Co-PLAN, por, si pasojë e ndryshimeve në strukturën e qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2017, në mungesë të MZHU-së, zyrtarisht nuk mbulohet roli i agjencisë bashkëpunëtoare;
2. Afatin e zbatimit të programit. Për shkak të “vakuumit” të krijuar postzgjedhor në riaktivizimin e strukturave, zgjatja e afatit të zbatimit të projektit, si nevojë e kohës për përfundimin e produkteve të tij nga 30.9.2018 deri më 31.3.2019.

Për dy çështjet e lartpërmendura propozohet edhe ndryshimi i marrëveshjes. Projektligji propozohet të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar, për shkak të afatit kohor të zbatimit, më 31.3.2019.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, si dhe përputhet edhe me vizionin evropian për zhvillimin rajonal, përkatësisht me Politikën Evropiane të Kohezionit, e cila ka për qëllim kryesor pikërisht promovimin e një zhvillimi të përgjithshëm harmonik, nëpërmjet forcimit të kohezionit ekonomik, social e territorial.

Miratimi i këtij projektligji nuk është planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj hartohet për të mundësuar ndryshimin e marrëveshjes për zbatimin e Programit për Zhvillimin e Rajoneve 3 (PZHR3). Dy pikat, të cilat donatorët e programit, të përfaqësuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri, paraqesin për zgjidhje në notën verbale nr.7F-07021-3, të datës 3.7.2018, reflektohen në ndryshimin e marrëveshjes, si më poshtë vijon:

Zgjatja e afatit të zbatimit të projektit, propozuar nga partnerët ndërkombëtarë, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar, gjithashtu, në vendimin e Komitetit Drejtues të RDP3, që është 31.3.2019 dhe konsiderohet real, bazuar në rezultatet e deritanishme dhe ato të pritshme, të parashikuara. Afati në marrëveshje ka qenë 30.9.2018, pra, do të ketë një shtyrje prej 6 (gjashtë) muajsh në kohë për aktivitetet e programit.

Agjencitë bashkëpunëtoresh/zbatuese të projektit, për caktimin e homologut dhe të pikës së kontaktit të projektit PZHR3, që do të marrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në marrëveshje, duke qenë se Ministria e Zhvillimit Urban, e cila ka nënshkruar marrëveshjen, duke përfaqësuar qeverinë shqiptare, nuk është më pjesë e strukturës aktuale qeverisëse. Propozohet që drejtimi i projektit të kryhet nga Zëvendëskryeministri për aspektet e lidhura me legjislacionin, politikën kombëtare për zhvillim dhe programimin kombëtar.

Gjithashtu, në kuadër të vënies në funksion të plotë të skemës institucionale të mekanizmit të zhvillimit rajonal, duke transferuar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit rolin e agjencive të zhvillimit rajonal, në zbatim të vendimit nr.438, datë 18.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e funksioneve të Agjencisë Kombëtare të Zhvillimit Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe agjencive të zhvillimit rajonal (AZHR) tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit”, propozohet që Fondi Shqiptar i Zhvillimit të jetë në rolin e agjencisë bashkëpunuese të projektit.

- Zëvendëskryeministri të jetë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve për arritjen e rezultatit 1 të projektit;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit të jetë bashkëpërgjegjës për arritjen e rezultateve 2 dhe 3 të projektit, si më poshtë vijon:
- Rezultati 1: Qeveria qendrore përcakton, bashkërendon dhe zbaton me sukses kornizën ligjore dhe institucionale për zhvillimin rajonal;
- Rezultati 2: Institucionet e reja për zhvillimin rajonal përdorin në mënyrë efikase dhe strategjike fondet e shtuara për zhvillimin e rajoneve, nëpërmjet një qasjeje me bazë partneritetin (FSHZH);
- Rezultati 3: Kushtet sociale dhe ekonomike për qytetarët që jetojnë në Shqipëri janë përmirësuar nëpërmjet zbatimit të projekteve të zhvillimit rajonal, të mbështetura në nevojat dhe prioritetet rajonale (FSHZH).

Ndryshimet e propozuara në marrëveshje janë negociuar me palët e partnerëve ndërkombëtarë, të cilët janë dakordësuar paraprakisht.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është i bazuar në Kushtetutë dhe në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është miratuar, në parim, me vendimin, nr.612, datë 19.10.2018, të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, miratuar me ligjin nr.66/2017.

Teksti i marrëveshjes ndryshuese përbëhet nga 8 (tetë) nene, të përmbledhura, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 ndryshohet shkronja “d”, e nenit I, të marrëveshjes në: “d) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga Zëvendëskryeministri.”.

Gjithashtu, pas shkronjës “d”, të nenit I, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë në rolin e agjencisë bashkëpunuese të projektit.”.

Në nenin 2 ndryshohet pika 1, e nenit II, të marrëveshjes në:

“1. Zëvendëskryeministri dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë agjencia bashkëpunuese e projektit.”.

Në nenin 3 ndryshohet afati i përcaktuar në pikën 1, të nenit IV, të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik për përfundimin e fazës 3 të programit, duke u shtyrë deri më 31.3.2019.

Në nenin 4 shtohet një paragraf në nenin VI të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik, që lidhet me aspektet e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar për 3 (tre) muajt e mbetur nga zgjatja e afatit të zbatimit të projektit, si më poshtë vijon:

“Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të vërë në dispozicion alokimet e nevojshme buxhetore për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) për projektin, përkatësisht në vlerën e mbetur nga diferenca e totalit të TVSH-së me vlerën e disbursuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të ndryshimit të marrëveshjes.”.

Në nenin 5 paraqiten ndryshimet në menaxhimin e projektit, përkatësisht në lidhje me drejtimin politik dhe zbatimin e tij nga pala shqiptare, si më poshtë vijon:

Fjalja e parë, e nenit VII, të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik ndryshohet me “Projekti është një ndërmarrje e përbashkët, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Zëvendëskryeministri, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, SDC-së dhe ADA-s, nëpërmjet Ambasadës Zvicerane.”.

Paragrafi i tretë, i nenit VII, të marrëveshjes, që përcakton përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Urban, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Nga ana e Zëvendëskryeministrit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit:

- Zëvendëskryeministri është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve për arritjen e objektivit 1 të projektit, përcaktuar në nenin II, pika 2/a, të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik, dhe pranimin e produkteve të arritura nëpërmjet këtij objekti;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit është bashkëpërgjegjës për koordinimin e aktiviteteve për arritjen e objektivave 2 e 3 të projektit, përcaktuar në nenin II, pikat 2/b dhe 2/c, të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik dhe pranimin e produkteve të arritura përmes këtij objekti.”;
- Zëvendëskryeministri dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si agjenci bashkëpunuese e projektit, ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve për të cilat është rënë dakord për projektin;
- Ofrojnë kapacitetet për të ndihmuar partnerin zbatues për pjesë të ndryshme të projektit;
- Ofrojnë qasje ndaj informacionit përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore, që mendohet se janë të nevojshme e të dobishme për arritjen e

objektivave të projektit. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e projektit. Çdo përdorim tjetër do t'i nënshtrohet lejes me shkrim të dhënë, paraprakisht, nga Kryeministria dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.”.

Në nenin 6 bëhen ndryshimet në përfaqësimin në komitetin drejtues të projektit, si më poshtë vijon:

- Pika 2/a, e nenit VIII, të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik do të ndryshojë në:

“Zëvendëskryeministri (bashkëkryetar i KDP-së)”.

- Pika 2/d, e nenit VIII, të marrëveshjes, do të ndryshojë në:

“1 përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (drejtori)”.

- Pika 2/e, e nenit VIII, të marrëveshjes, shfuqizohet. Kjo, në zbatim të vendimit nr.438, datë 18.7.2018, të Këshillit të Ministrave.

- Pika 5/a, e nenit VIII, të marrëveshjes do të ndryshojë në:

“1 përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit”.

Në nenin 7 propozohet shtyrja e afatit të përcaktuar në nenin XVII, të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik për periudhën që mbulon marrëveshja, nga 30.9.2018 deri në datën 31.3.2019, dakordësuar kjo me palët dhe miratuar me vendim të Komitetit Drejtues të projektit.

Në nenin 8 janë vendosur klauzolat e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ndryshuese. Marrëveshja ndryshuese mbulon periudhën prej 30 shtatorit 2018 deri më 31 mars 2019. Ajo do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Zëvendëskryeministri, si dhe institucione të tjera që, në objektin e veprimtarisë së tyre, kanë zhvillimin rajonal në Shqipëri.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Kryeministria dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Granti për fazën e 3-të është 3 445 000 CHF dhe, referuar marrëveshjes Ministria e Zhvillimit Urban do të vinte në dispozicion shpërndarjet e nevojshme buxhetore për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) për projektin, për një shumë maksimale prej 380 000 (treqind e tetëdhjetë mijë) frangash zvicerane, të konvertuar në lekë.

Aktualisht, vlera e mbetur e TVSH-së është transferuar në buxhetin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Mbulimi i buxhetit të TVSH-së, përkatësisht vlerës së mbetur nga diferenca e totalit të TVSH-së me vlerën e disbursuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të ndryshimit të marrëveshjes, do të mbulohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ndryshimi i marrëveshjes nuk ka impakt në buxhet.

KËSHILLI I MINISTRAVE